

Lajmëtari

ORGAN I KOMITETIT TË PARTISE TË RRETHIT TEPELENE

VITI i 4-t

Nr. 15 (163)

E martë, 9 prill 1991

Çmimi 20 qindarka

PUNE, PRODHIM, STABILITET

Shumë herë e kemi shtruar këtë kërkesë këto kohët e fundit. E përsëri reflektimi ka qenë i pamjaftueshëm. Ethet elektorale dhe pasionet politike patën ndikimin e vet në këtë çështje. Por, gjithësesi, u tepërua me indisiplinimet dhe mosrealizimet e vrejtura në sektorin e ekonomisë. Ja, krahasojmë plotësimin e detyrave të 3-mujorit të sivjetshëm me ato të vitit të kaluar. Bilanci i plotë nuk është bërë, pasi të dhënat e nde po përpunohen në zyrën përkatese të Komitetit Ekzekutiv, por diferenca është e dukshme. Mijra lekë prodhim industrial më pak në shkallë rrethi, shumë ndërmarrje ekonomike me detyra të paplotësuara, prapamjetje e theksuar në mbjelljet pranverore dhe shërbimet e tjera në bujqësi, mosrealizime të dukshme edhe në blegtori etj. Tregu i qytetit është bosh, sepse edhe parcelat e perimeve në NB s'kanë prodhimin e gatshëm stinor. Edhe mbjelljet e mëvonshme në këtë drejtim janë të cingura dhe të afateve optimale. (Thua se kanë parandjerë prodhim të pakët nga kjo ekonomi qytetarët që i kanë mbushur anët e lumenjve pranë qytetit plotë me kopshte të mbarsa?) Ndërsa vitin e ka-

luar e njëjta periudhë ishte më e begatshme, shumë herë më e begatshme. Bile edhe shumë herë më e qetë.

Njerëzit e ndershëm, punëtorët dhe kooperativistët, intelektualët e denjë, veprihtarët e palodhur etj., 31 marsin e kanë konsiderur kufirin e fundit të gjëndjes aktuale në ekonomi dhe në jetën politiko-shoqërore. Ndaj, dhe votën e tyre ia dhanë Partisë së Punës, asaj forcë politike që tërë jetën i ka edukuar me dashurinë për punën, me dashurinë për Atdehun, me dashurinë për njeri-tjetrin. Historia na mëson se populli s'mëshiron kurrë kur sheh se bijtë e tij e braktisin në jetë. Ai i shkon pas atij prijisi që e ka mendjen të kthjellët dhe perspektivën të qartë. Zgjedhjet e 31 marsit treguan se populli votoi për Partinë e Punës atje, ku komunistët janë shquar si njerëz punëtor, të ndershëm e me aftësi të mira udhëheqëse. Votoi atje ku anëtarët e Partisë së Punës i kanë ndarë gëzimet e hidhërimet bashkë me popullin. Mbi të gjitha fitorja e PP-së në zgjedhje ishte një provë e lidhjeve të saj me masën, me punën, me Shqipërinë. U bind edhe bota për këto. Vetëm opozita dhe ata që s'ia duan të mi-

rën Shqipërisë nuk janë bindur. Herët ose vonë do të binden dhe ata. Punë e tyre, por punëtorit, intelektualit të ndershëm, patriotit të nderuar, qytetarit që është në hallin e vet s'kanë pse i bien në qafë kot së koti. Në rrethin tonë s'ka pasur probleme të tilla, bile me opozitën po mirëkuptohemi, por ndodhitë e Shkodrës, Durrësit, Tiranës etj., s'kanë si të mos shqetësojnë të madh e të vogël këtu në Jug, deri në zonën më të thellë të çdo rrethi.

Fitorja në zgjedhje e ka vënë Partinë e Punës, çdo organizatë - bazë dhe çdo komunistë përballë detyrash të reja. Popullit, besimin që pati në aftësitë tona, në karakterin tonë, në forcën tonë, i duhet shpërblyer me punë e përkushtim të lartë. Për këtë qëllim; militantizmi i komunistëve, organizimi i brendshëm i Partisë së Punës, në fund të fundit, komplet platforma rinovuese e saj, duhen përshtatur në kohë. Aspektet e rinovimit të deritanishëm në kuadrin e demokratizimit të gjithë jetës së vendit tregojnë se ç'forca e mundësi ka Partia e Punës për t'i çuar deri në fund premtimet e bëra para popullit të vet.

FETI ZENELI

Javën e kaluar Komiteti Ekzekutiv i KP Rrethit organizoi një takim me kuadrot drejtuese të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë në rreth lidhur me gjëndjen aktuale të realizimit të detyrave, problemeve që kanë të bëjnë me punësimin e njerëzve, strehimin dhe furnizimin e popullit.

Kryetarët e këshillave popullore si dhe drejtorët e ndërmarrjeve e kryetarët e ekonomive bujqësore që e morën fjalën në këtë takim, vunë në dukje se krahas shqetësimeve që vazhdojnë të ekzistojnë për çështjet që u trajtuan në takim, kohët e fundit vihet re një angazhim më i mirë i njerëzve në punë, një ndjenjë më e lartë e përgjegjësisë për përmirësimin e gjëndjes ekonomike të rrethit. Në këtë drejtim u shtrua si detyrë parësore përmirësimi i drejtimit dhe organizimit e sidomos forcimi i disiplinës në punë. Në mënyrë të ve-

çantë drejtoritë e ndërmarrjeve duhet të veprojnë pa hezitim dhe tolerancë për zbatimin e rregullave dhe ligjeve në punë. Vetëm forcimi i disiplinës, u tha në takim, mund të çojë në përmirësimin e treguesve të ekonomisë së rrethit.

Këto ditë në sallën e Plenumit të Komitetit të Partisë së rrethit filloi shpërndarja në mënyrë të organizuar e dokumentave të reja të Partisë. Shpërndarja e këtyre dokumentave filloi me komunistët veteranë dhe pastaj me komunistët e ndërmarrjeve dhe institucioneve. Shumë ngjë komunistët duke marrë dokumentin shprehnin me këtë rast dhe një herë vendosmërinë e tyre për zbatimin e programit të PPSH dhe porosive të shokut Ramiz Alia, për të qenë kurdoherë në ballë të punës, në ballë të vështirësive dhe të lidhur ngushtë me popullin për kapërcimin me sukses të situatave që po kalon vendi ynë aktualisht.

Kolektiv pararojë

Ndërmarrja ushqimore e rrethit është ndër më të dalluarat për plotësimin e detyrave të planit për tre-mujorin e parë të këtij viti. Në mënyrë të veçantë ajo ka plotësuar ritmiksht zë-

rin e saj kryesor mall i shitur. Kolektivi i ndërmarrjes ushqimore i cili përbëhet në një përqindje të madhe prej shoqesh, dallohet dhe për një disiplinë të mirë në punë dhe mobilizim të lartë.



Në foto: Çaste pune nga reparti i përpunimit të qepujkës. (Foto: TH. BRUZHOL)

Përshtkrim

Ata që e kanë parë fshatin Luadh, padyshim që janë të pakët. Ndoshta disa e dëgjojnë përherë të parë këtë emër të ri që ka zënë vend në hartën e rrethit si një ndër më të rinjtë e viteve të fundit. Fjalën e kam për ish-lagjen Keçerisht të Zhapokikës Nr. 2. I vogël në numër shtëpish e banorësh, por i madh në motive. Prezantimin e parë na i bëjnë sytë tanë të cilët ballohen me të kur del në Qafën e Cacajt. Si «grusht», shtëpitë janë montuar atje në gjoks të malit, në formë

MBI DHE NËN TOKEN E LUADHIT

gjysëm harku. Pyesim sekretarin e byrosë së Partisë së Punes të kooperativës, Muharrem Doko se ç'janë ato shtëpi atje...

- Është Luadhi, - përgjigjet ai.

Biseduam gjatë për këtë fshat, por le t'ia lëmë vendin shënimeve që shkëputëm kur shkua atje.

...Luadhi ka vetëm 25 shtëpi, të traditës dhe të reja, brenda të cilave «gatuajne» jetën me duart dhe mendjet e tyre afro 150 ba-

norë. Edhe pak gjeografi. Janë tre lagje gjithsej, nga jugu Pazaj, nga perëndimi Qenanaj dhe nga veriu Visha e Kalemaj. Ndonëse të ndara gjeografikisht ato janë të bashkuara shpirtërisht, në punë dhe në jetë, si shokë, miq e vëllezër. E tha mirë Seiti, minatori veteran: - Jemi vërtet 25 familje, tamam sa një fis por shkuarja në unifet me njeri-tjetri na afron më shumë se kaq, na bën vëllezër. Si prindi fëmijës ia dimë hallin

shoku - shokut». Njerëzit këtu jetojnë tamam si në qytet. Asgjë nuk u mungon. Qetësinë ua ka siguruar puna e ndershme ndaj dhe i gëzohen e nuk i ndahen asaj. Mirpo kjo, puna e luadhasve, ka edhe të veçantën e vet e cila është tepër kuptimplotë. Njerëzit e këtij fshati i kanë frontet e punës mbi dhe në nëntokën ku jetojnë. Dhe nuk ka asgjë për t'u çuditur në këtë drejtim. Mbi tokë përrreth fsha-

tit ata kultivojnë e prodhojnë bereqet perime ndërsa pjesa tjetër e forcave të punës, e sidomos e burrave, punojnë poshtë themeleve të shtëpive, thellë në nëntokë.

Ç'bëjnë? Nxjerrim qymyrin. Futen në Pusin 6 dhe ecin rrugëve të nëndheshme deri sa arrijnë poshtë banesave, e rrënjëve të pemëve, poshtë parcelave ku hedh shtat gjelbërimi i kësaj pranvere.

Punë mbi e nën tokë. Po ta përfytyrosh këtë të krijohet një imazh i tillë: Traktorët, kazmat dhe shatat mbi tokë duket sikur i përgjigjen goditjeve dhe zhur-

(vijon në faqen 3)

ORGANIZATAT BAZE TE PARTISE PERBALLE DETYRASH TE REJA

Fitorja e kandidatëve të PPSH në zgjedhjet e 31 marsit, ishte një fitore e madhe e vet Partisë dhe e popullit, që aspiron programin e saj, që dëshiron vazhdimin pandërprerje të proceseve të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së vendit. Fushata elektorale që sapo mbyllëm ishte njëkohësisht dhe një gurë prove për çdo organizatë - bazë partie e komuniste, për çdo intelektualë e punonjës të thjeshtë. Për Partinë ajo do të justifikonte përmasat e lidhjes së saj me masat për të tjerët devotshmërinë e tyre për të ecur në rrugën e saj. Komunistët dhe në përgjithësi populli i rrethit tonë e kaluan me sukses të plotë këtë provë. Nga 28454 zgjedhës që morën pjesë në votime 21074 ose 74 për qind të tyre votuan për kandidatët e PPSH. Në këtë fushatë shumë komunistë, punonjës të thjeshtë dhe intelektualë afirmuan edhe një herë dashurinë e tyre për PPSH, aftësitë e tyre si agjitorë të PPSH e luftëtarë të vijës së saj.

Tani si kudo në vendin tonë dhe në Tepelenë, organizatat - bazë të Partisë, do t'i përvishen punës për ta konsoliduar plotësisht këtë fitore të madhe, duke nxjerrë mësimet e nevojshme nga lufta elektorale dhe dukuritë e saj. Në radhë të parë mësimet do të nxjerrin ato organizatat - bazë Partie ku një pjesë e madhe zgjedhësish ia dhënë votën e tyre PD-ës. Këto organizatat - bazë partie me ndjenjë të lartë përgje-

gjësie duhet të shohin ato dobësi të punës së tyre që çuan largimin e masave nga PPSH-ja. Mbi bazën e konkluzioneve të kësaj analize të ndërtojnë marrëdhëniet e tyre me njerëzit. Pse nuk ka se si të pranohet që fshati Gusmar të jetë kundra kandidatit të PPSH në një kohë që ky fsat në vitet e LNÇI ishte lidhur ngusht me PKSHP dhe pas çlirimit një nga fshatrat që mbështeti fuqimisht rrugën e Partisë dhe masat që ajo mori për ndërtimin e jetës së re, fshat që i dha atdheut 11 dëshmorë.

Në këtë fushatë të madhe shumë të rinj e sidomos intelektualë u angazhuan tërësisht për propagandimin e kandidatëve të PPSH dhe punuan me njerëzit që të hidhnin votën e tyre për ata. Këtë masë veprimtarësh të dalluar, organizatat - bazë të Partisë duhet t'i mbajnë afër dhe të pranohen nga radhët e tyre në PPSH më të zotët, më të devotshmit. Nga ana tjetër organizatat - bazë të Partisë duhet të shikojnë me ndjenjë përgjegjësie dhe ata komunistë që gjatë kësaj periudhe të provës u treguan të mëfshët, indiferentë madje me qëndrimet e tyre u bënë më tepër mbështetje të propagandës së PD-ës se sa të PPSH-ës.

Fushata elektorale në një farë mase çoi dhe në çënimin e unitetit të popullit. Është në interes e të gjithëve që uniteti në popull të jetë i plotë. Secili ka të drejtë të ruaj pikpamjet e tij politike e t'i mbrojë ato

kur të jetë nevoja, të votojë për atë që dëshiron kur vjen fushata elektorale. Por në jetën e përditëshme, në punë, në shoqëri në marrëdhëniet midis njeri - tjetrit njerëzit duhet të shkojnë mirë. Pluralizmin politik të cilin e pranoi PPSH-ja është forma më e lartë e demokracisë e konfirmar në shumë dokumenta ndërkombëtare, është forma e debatit të lirë, e debatit të çliruar nga klishetë dhe paragjykimet, nuk është forma e urrëjtjes dhe e ballafaqimit me dhunë. Në këtë luftë elektorale do të fitonte ajo forcë politike që gëzonte më tepër besimin e popullit. Fitoi PPSH-ja. Kush nuk e kupton kështu nuk mund të jetë demokrat e akoma më pak komunistë. Këtë duhet ta kenë mirë parasysh organizatat - bazë të Partisë në punën e tyre me njerëzit, duke mbajtur njëkohësisht lart vigjilencën për të mos rënë pre e provokacioneve, për të forcuar unitetin mes njerëzve e në mënyrë të veçantë për mobilizimin e tyre për realizimin e detyrave ekonomike. Me përparësi byrotë e organizatat - bazë të Partisë duhet të punojnë gjatë kësaj periudhe për të zgjidhur ato kërkesa që paraqiti populli gjatë fushatës elektorale, duke rritur kështu dhe besimin e tij ndaj Partisë së Punës dhe deputetëve të saj për të cilat dha votën. Me këtë angazhim komunistët do të shkojnë dhe në zgjedhjet që fillojnë së shpejti në organizatat e Partisë

JORGO ZHONGA

REMONTI E ARDHMJIA E TUFES

Shkputja e qëngjave nga nëna ka kohë që është bërë ndërsa ka filluar edhe ndarja e kecape. Kujdesi për të

të më të zotë e të pasionuar. Mos të harrojmë pasojat e rënda që kemi paur kur vëmendja kryesore është për-



vegjëlët është detyra parësore në blegtori. Remonti është e ardhmja e tufës. Që të realizohet kjo me këto tufa kërkohet të vihen barinj-

qëndruar mbas prodhimit të qumështit, dhe janë lënë pas dore kujdesi e shtesat e peshës për qëngjat dhe kecat.

Korresp. i «Lajmëtarit»

SHITJA E TEPRICAVE NE SHITET ESHTË ME INTERES PER FSHATARIN

Me ndryshimet e bëra në oborrin kooperativist do të krijohen dhe teprica në prodhimin e qumështit, sidomos në periudha të prodhimit të maksimale të kafshëve.

Ka dy rrugë të përpunimit të tij. E para: të çohet në baxho e të shitet me lekë në dorë. E dyta: të përpunohet nga vet fshatari në shtëpi dhe të shitet në treg si produkt i gatshëm (djathë, gjizë, gjalpë). Cila nga këto dy rrugë është më me interes për të?

Natyrisht që fshatari e di vet se ku i del leverdia por ne nëpërmjet këtij shkrimi duam të bëjmë një analizë me shifra të kësaj leverdie. Ai le të zgjedh rrugën që dëshiron.

Konkretisht: Në qoftë se fshatari do të prodhonte brënda 5 ditëve 1 kv qumësht tepricë nga lopa ose dhiti, nga shitja e tij në baxho do të fitonte jo më pak se 260 lekë. Po të ndjek rrugën e dytë ai do të fitonte nga përpunimi i tij 13.5 kg djathë me një vlerë prej 230 lekë, 0.2 kg gjalpë me një vlerë 6.7 lekë, 2.3 kg gjizë me një vlerë prej 17.3 lekë. Nga shitja e këtyre produkteve në treg ai do të fitonte gjithsej 240 lekë. Për realizimin e këtij prodhimi në kushte shtëpiake do të harxhonte për lëndë ndihmëse (kripë, farë djathi, kimikate etj.) 7.5 lekë dhe angazhimin një krah - pune që po të investohej në kooperativë do të siguronte një përfitim së paku 50 lekë. Po që se sasia prej 1 kv do të realizohej jo në 5 po në 10 ditë atëherë dhe sasia e kohës së

përpunimit do të dyfishohej. Vështirësi jo të vogla do t'i dilnin fshatarit dhe për ambalazhimin e prodhimit të përpunuar në shtëpi, për transportin e tij në treg, shpenzime këto që zenë jo më pak se 1.5 për qind të të ardhurave ose të paktën 16 lekë. Me një përlllogaritje të përafërt fshatari në 1 kv qumësht të përpunuar në shtëpi humbet duke e shitur atë në treg 70 lekë dhe i mbetet një e ardhur neto 170 lekë, ose 23 për qind më pak nga shitja e qumështit të freskët direkt në baxho.

Veç këtyre fshatari do të kishte humbje të konsiderueshme dhe në cilësinë e nënprodukteve të qumështit për shkak të mungesave të bazës materiale e mjediseve të ruajtjes që shoqërohen me firo sasijore të cilat shkojnë jo më pak se 5 për qind ose 12 lekë për 1 kv qumësht.

Nga këto përlllogaritje të përafërta duket qartë interesi që do të ketë fshatari po ta shes tepricën e prodhimit të qumështit të freskët në baxho e shtetit. Kjo nga ana tjetër do ta lehtësojë atë nga shumë punë të panevojshme e do t'i kursejë kohë që është e çmuar për t'u angazhuar në veprimtari të tjera të familjes. Familja tepricën e prodhimit të qumështit mund ta çojë dhe individualisht në baxho por dhe mund të bashkohen grup familjesh me fis ose lagje si t'u vijë për mbarë, me kontratë me baxhën ose dhe pa kontratë.

HATE DAUTI
Ing. Kimist

Pse po humbet një traditë e mirë ?

- VEZHGIM -

Si rreth me përparësi të shumta për zhvillimin e blegtorisë, të trashëguara nga e kaluara e të zhvilluara me mendësi të reja në vitet e fundit, është e natyrshme të kërkohet më shumë prej kësaj dege. Të kërkojmë jo vetëm qumështin, numrin e krerëve, mishin etj. po edhe nënproduktet e tyre për të gjithë vitin. Në dhjetëvjeçarin 80-90 rendimentet u rritën shumë për çdo krerë e lloj të gjëse së gjallë. Ishin investimet e bëra në kullota e strehime, remonitim e shtesë të numrit të krerëve që rritën prodhimet. Por jo pak influencuan edhe ato forma pune nxitëse që bëheshin për çdo muaj e që i quanim ballafaqime të blegtorëve. Ishte bërë e traditës që një herë në muaj bari-njtë të takoheshin në ekonominë më të mirë të rrethit. Atje shkëmbehej përvoja e mirë, raportohesh për detyrat

e muajit, merreshin zotime, po dhe kritikoheshin rëndë të prapambeturit. Secila tufë e k/bari para se të shkonte në aktivin e rrethit bënte bilancet e veta në brigatë, këto të fundit në ekonomi e pastaj i drejtoheshin aktivitetit që zhvillohej në shkallë rrethi. Kështu veprohej jo vetëm për prodhimin e qumështit por edhe për pjellorinë; për shtesat e peshës dhe numrin e krerëve. Besoj se të gjithë ata që merren me këto punë i mbajnë mend këto e të tjera si këto.

Por na duket se po i largohemi një traditë të tillë. Fakti që për vitin e kaluar u zhvilluan tre, katër ballafaqime e për këtë periudhë 3-mujore as edhe një, e tregon qartë e s'është komentuar më gjatë. Po pse ndodh kështu, mund të pyetet. Sa e vlerësojnë specialistët në ekonomi dobënë e ballafaqimit të punës së blegtorit, me

ata të kooperativës më të afër e me të tjerë, e dinë vetë e s'u hyjmë në pjesë. Por faktit që në to shpërthente një garë midis ekonomish, ambicja e sedra e punës shkundte këdo, që i nderuari gjente vendin e merituar e i prapambeturit s'dinte ku të futej atë ditë; pa folë për informimin dhe vlerat e ndjekjes së detyrave, nuk mund t'i shmanget asnjëri.

Mendojmë se nuk është vonë që t'i rikthehemi asaj traditë të mirë. Për të duhet të mendojmë mirë si specialistët e seksionit ashtu edhe ata të stacionit bujqësor dhe ekonomive përkatëse. Veç të mirës asgjë nuk humbasim po të veprojmë si vitet e shkuara. Do të fitojmë në sasi proanim e rendimentet do të rriten.

Korresp. i «Lajmëtarit»

NGA VEPRIMTARIA E ORGANEVE TE PUSHTETIT

MBI ÇDO GJE INTERESAT E POPULLIT

Organet e Pushtetit në rreth mbas kurorëzimit me sukses të fushatës së madhe të zgjedhjeve për deputetët e Kuvendit Popullor janë duke e përqendruar vëmendjen e tyre në ato drejtime që lidhen ngushtë me demokratizimin e mëtejshëm të jetës së rrethit dhe interesave imedjate të popullit.

Një ndër objektivat kryesore të punës së tyre, si në rreth dhe në bazë, është rivendosja e stabilitetit të plotë të punëve në ndërmarrjet dhe ekonomitë bujqësore duke ballafaquar me ligjin çdo shfaqje apo tendencë që çon në çoroditjen e punëve, në shkeljen e rregullave, që pengon ecurinë normale të ndërmarrjeve dhe ekonomive bujqësore. Këtij qëllimi i shërbeu dhe takimi që u organizua këto ditë nga ana e Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit me kuadrot drejtuese të organeve të pushtetit të dy qyteteve dhe fshatit të bashkuar, me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe ekonomive bujqësore. Siç u vu në dukje nga pjesëmarrësit e këtij takimi gjëndja e punëve në rreth, me gjithë përmirësimet e bëra akoma nuk është stabilizuar plotësisht. Ka mungesa pa arsye në punë, ka mosrealizim normash, defekte serioze në organizimin dhe drejtimin e punëve, sigurimin e bazës së nevojshme materiale e tjera dobësi, kryesisht të karakterit

subjektiv. Me pasoja më tepër negative janë në këtë drejtim mungesat në realizimin e treguesve të kohës në sektorin e bujqësisë. Duke pranuar të metat e dobësitë e punës së tyre shumë dretjues u angazhuan njëkohësisht për një mobilizim më të mirë dhe për një reflektim të shpejt.

Aktualisht organet e pushtetit në rreth shqetësim të dorës së parë kanë çështjen e strehimit të popullit, ku ata kanë përqendruar dhe vëmendjen e tyre. Po vazhdohet puna për këtë problem nëpërmjet investimeve shtetërore që realizohen nga ndërmarrja e ndërtimit, nëpërmjet ndërtimeve që kryen nga vetë ndërmarrjet dhe ndërtimeve private me kredi nga shteti, në qytetin e Tepelenës dhe Memaliaj. Për këtë janë marrë masa për sigurimin e shesheve të ndërtimit. Objekt tjetër kryesor i punës së organeve të pushtetit në rreth është furnizimi i popullit me produkte ushqimore. Është siguruar sasia e nevojshme për një furnizim ritmik të tregut me makarona, oriz, miell, vaj, sheqer dhe po merren masa për garantimin e furnizimit të popullit me mish për periudhën e gjashtëmuajorit të dytë. Kemi patur dhe vazhdojmë të kemi mungesa të theksuara në treg për qumësht dhe nënproduktet e tij. Për këtë janë marrë dhe po merren një varg masash

për përmirësimin e furnizimit me këta tregues. Po kështu organet e pushtetit në rreth në bashkëpunim me ato të tregtisë janë duke marrë masa për përmirësimin e furnizimit të tregut me perime, duke tërhequr dhe nga rrethet e tjera.

Në këtë drejtim janë tepër shqetësues dhe dëmtrimet që po u shkaktohen parcelave të mbjella me perime në NB të rrethit. Kemi mendimin se kjo nuk duhet të preokupojë vetëm drejtuesit e ndërmarrjes bujqësore por dhe ata të organeve të pushtetit të qytetit të Tepelenës dhe Memaliajt dhe organizatat e masave.

Kontrolli mbi krijimin e kushteve të punës dhe të prodhimit të ndërmarrjeve ekonomike të rrethit është një tjetër drejtim në të cilin është angazhuar Komiteti Ekzekutiv i KP Rrethit dhe që ka patur mjaftë shqetësime.

Në zbatim të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 7476 datë 12.3.1991 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim, Komiteti Ekzekutiv në bashkëpunim me ndërmarrjet ka krijuar grupet e punës për përcaktimin e degëve, sektorëve dhe ndërmarrjeve që do të kalojnë nga veprimtaria shtetërore në veprimtari private apo në bashkëpunim me firmat e huaja.

AHMET ÇAÇI

MBI DHE NEN TOKEN E LUADHIT

(vijon nga faqja 1)

mave të pistoletave e kazmave të nëntokës; duket sikur minatorët nga Luadhi, atje në nëntokë, prekin me duar rrënjët e grurit, themelet e shtëpive, të gjithë këtu sipër. Me djersë të dyanshme vadisin jetën luadhasit; të duket se forcojnë edhe më shumë themelet që ndërtojnë vëllezërit e motrat lart, tyre... «Paçka se burrat sigurojnë të ardhura të mira në gale-ritë e qymyrit, në Luadh njerëzit e shohin të ardhmen e tyre të lidhur ngushtë me kooperativën buj-

qësore». Këtë na i ka thënë disa kohë më parë, kryetari i ekonomisë Ferik Mahmuti dhe kryetari i këshillit popullor të fshatit të bashkuar, Sami Alimema.

Ka dhe më shumë për të thënë për këtë fshat të futur midis gjelbërimit të përherëshëm. Unitetin e kanë si gjë në më të shtrenjtë, e në vitet e pushtetit popullor ata e kanë forcuar edhe më tepër me punë e djersën e tyre, me dashurinë dhe respektin që u vlon në zemër për Partinë e Punës.

PËRPARIM HALILI

FUTBOLL

Dy fitore të merituar

Filloi faza e dytë e kampionatit kombëtar të kategorisë së dytë në futboll. Të dyja ekipet tona në javën e parë fituan, madje me rezultate bindëse për vazhdimësi të mirë edhe për të ardhmen. «Minatori» i Memaliajt fitoi pastër kundër ekipit të «Bistricës» me dy gola të shënuar nga Hyesani në minutën e 35 dhe të Llakajt në të 70-tën. Ekipi vendas dominoi me lojë tek nike në të dyja pjesët e lojës.

«Minatori» i Tepelenës e zhvilloi takimin e javës së parë jashtë fushës së tij

Në qytetin e Leskovikut ai u ndesh me «Melesinin» vendas. I pari shënoi Nela dhe pastaj Ruçi për ekipin tonë, ndërsa për vendasit një gol i shënuar prej tyre e shkurtoi rezultatin e pjesës së parë në 2:1. Në pjesën e dytë Zotaj i «Minatorit» e ngriti në 3:1 rezultatin i cili mbe ti kështu deri në përfundim të saj.

Janë këto dy fitoret e para. Sportdashësit e qyteteve tona u urojnë të tilla fitore edhe për të ardhmen.

Korresp. vullnetar i «Lajmëtarit»

Disa ndryshime të ligjit Nr. 4171

Kohët e fundit doli Dekreti Nr. 7482 që bën fjalë për disa ndryshime të ligjit 4171 për sigurimet shoqërore e shtetërore, të cilat pasqyhojnë qartë në nenet e tij. Kështu raportet për paaftësi të përkohëshme në punë, për shoqërim të sëmurësh dhe për leje barrë - lindje, i interesuari do të paguhet me përqindjen e caktuar bazuar në mesataren e të ardhurave të vitit të fundit kalendarik dhe jo për muajin ose tremujorin e vitit të fundit siç ka qenë deri tani. Konkretisht për emërtesat që paraqitën më lart ai paguhet me 70 për qind të mezatares vjetore të vitit të kaluar.

Për raportet e shtatzanisë e asaj të paslindjes, gruaja punëtoresh dhe nëpunëse për kohën që gëzon këtë leje merr 80 për qind të pagës mezatare ose të realizuar si të tillë për vitin e fundit paraardhës. Kështu në qoftë se leja do t'i fillojë më da-

tën 1 prill të vitit 1991 80 për qindëshi do t'i llogritet e nxirret nga viti 1990.

Kur me vendim të komisionit mjeko - ligjor një punëtor caktohet në një punë më të lehtë për paaftësi fizike ose me orë të reduktuara, por jo më shumë se tre muaj, ka të drejtë të marrë deri 50 për qind të pagës së vitit të fundit por paga e përgjithëshme (bashkë me shtesat e sigurimeve) të mos kalojë mesataren e realizuar në vitin e paraardhës, para paaftësisë së tij. Ndërsa për shoqërim të fëmijëve të sëmurë apo edhe për të rritur, shoqëruesi shpërblehet për sa ditë raport me 600 për qind të të ardhurave të vitit të fundit kalendarik. Për ushtarakë aktivë kur kanë vjetërsi më raport paguhet 80 për qind dhe kur kanë mbi pesë vjet punë 95 për qind të pagës mezatare të vitit të kaluar.

Në nenin 3 të këtij dekreti thuhet: - Invalidi i grupit

të tretë dhe të katërt e merr pensionin e invaliditetit pavarësisht nëse punon apo jo dhe pavarësisht nga të ardhurat që realizon nga puna. Kështu fuqizohet neni 26 i cili nuk lejonte tejkalimin e pagës mbi të cilën ishte lidhur pensioni. Gjithashtu në këtë dekret ka edhe ndryshime të tjera për të cilat të interesuarit të paraqiten pranë degës së sigurimeve shtetërore e shoqërore për tu qartësuar edhe më shumë.

Por deshëm të theksonim se ky dekret ka shkuar edhe në të gjitha degët e financës të ndërmarrjeve ekonomike, të cilat me shpejtësi të bëjnë veprimet përkatëse. Zbatimi i ndryshimeve ka filluar ligjërisht që prej 4 janarit të këtij viti.

AVDUL SULO

Drejtor i Sigurimeve shtetërore e shoqërore të rrethit



Mes talentëve të rrethit tonë dallohen për një punë më të dendur krijuese ata të artit të pikturës.

Vitet e fundit kanë çelur disa ekspozita kolektive që janë mirëpritur nga shikuesit.

Në foto: piktori Alosha Bilbili gjatë punës.



që mos të ndeshet me dëmtime të tilla. Këto jorralë kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë, sidomos midis atyre kirurgë, neurologë, traumatologë, reanimatorë neurokirurgë etj. Çdo mjek

u kushtohet edhe rrjedhëve të hershme e të vonshme të traumave kafkotru-nore, ekzaminimeve të shu-mta që kryhen në kësi rastesh, parandalimit dhe riatësimi të këtyre të sëmu-

T'I FALEMI «STINES» SE PASOSUR TE PUNES

- Intervistë e redaktorit të gazetës sonë, Zenel Çulli me mjekun neurolog Izet Çulli -

- Është libri i tretë që botoni nga fusha e mjekësisë, ju lutem, na thoni diçka për lexuesin se kur e keni shkruar atë dhe ku qëndrojnë vlerat e tij?

- Libri i ri «Goditjet në kokë dhe pasojat e tyre» që doli nga shtypi këto ditë është shkruar me bashkautor k. sh. mjekësore Stavri Furxhi, kolegun tim fierak. Për këtë kemi vëzhguar e punuar së bashku disa kohë, pasi problemi i goditjeve të kafkës dhe të trurit me rrjedhojat e tyre të shumta e shpesh të rrezikshme për jetën na kanë shqetësuar gjatë praktikës së përditshme, sidomos në fëmijët e në moshat e reja dhe aktive për punë. Nuk ka mjek, pavarësisht nga specialiteti,

duhet të bëjë kërkime e përgjithësime në punën e tij. Heminguej ka shkruar: «Po që se një shkrimtar pu-shon së vëzhguari, atëherë ai ka marrë fund». A nuk mund të thuhet kjo edhe për mjekun...?

- Dr. Izeti, na shtjelloni disa nga problemet që trajtoni në libër?

- Po. Ndonëse me faqe të kursyera e stil disi lakonik, libri përmban 8 kapituj, ku zbërthehen thjesht çështje të ndërlikuara të neuropatologjisë si: gjendja e vetëdijes dhe e simptomave të tjera neuropatologjike, tre-guesit jetësorë dhe trubullimet e tyre, format klinike, llojet e shkallët e dëmtimeve të trurit, parimet e trajtimit. Po ashtu rëndësi

rëve, disa rekomandime me vlera praktike etj.

- Ku mbështeteni në studimin tuaj dhe kujt i shërbën më shumë ai?

- Punimi ynë i ilustruar me fotografi të sëmurësh, pamje, skica etj. mbështet në një numër të madh rastesh nga praktika jonë e me të dhëna të bollshme nga literatura bashkëkohore, duke tërhequr vëmendjen për një numër të madh njerëzish, sepse ato u interesojnë të gjithëve për shkak të automatizimit të jetës në përgjithësi, zhvillimit të vrullshëm të mekanizimit të industrisë, shtimit të mjeteve të qarkullimit rrugor, mosrespektimit të rregullave të sigurimit teknik në punë.

Duke e parë problemin e këtyre traumave në të gjitha këndvështrimet (mjekësore e shoqërore) studimi ynë «Goditjet në kokë dhe pasojat e tyre» do t'ju vlejë si personelit të shëndetësisë ashtu edhe të dëmtuarve, të afërmëve të pacientëve dhe atyre që interesohen për të fituar njohuri e zgjeruar më tej horizontin shkencor në fushë e traumave të një organi të tillë të rëndësishëm, siç është truri dhe mbulesat etj.

- C'plane studimore keni për të ardhshmen?

- Kemi përgatitur me bashkautor (siç karakterizohen sot studimet në shkencë) një monografi të gjatë për urgjencat neurologjike dhe reanimimin e tyre, një punë gati dhjetëvjeçare për pasunivërsitarët. Po ashtu kam grumbulluar të dhëna për disa artikuj shkencorë nga praktika jonë e përditshme së bashku me kolegë të spitalit të Tepelenës, recensione shkencore, shkrime divulgative për revista të ndryshme etj., që po u japim tani dorën e fundit...Mos të ngopemi duke punuar. T'i falemi «stinës» së pasosur të punës! Gëte ka thënë: «gjer edhe mjeku duhet të jetë prodhimtar në se dëshiron të mjekojë me të vërtetë...».

GJIGANDET

● Gjigandi Edi Karmel (lindur në Tel - Aviv më 1938) i njohur me emrin «njeriu më i gjatë i botës» që paraqitur nën tendën e cirkut Barnum si një kollos 275 cm i gjatë, me masën 242 kg.

● Robert Pershing Uodllo (1918-1940) SHBA, peshonte kur lindi 3.8 kg. Kur ishte dy vjeç u operua nga një hernie e dyfishtë dhe nisi të zgjatej në mënyrë jo normale për të arritur në 272 cm në moshën 22 vjeçare. Shputat e këmbëve të tij qenë 47 cm, kurse duart 32.5 cm të gjata dhe kur vdiq e varrosën me një arkivol 3.30 m të gjatë.

● Gabriel Monzhan, i lindur në Mozambik më 1944, kap 245.7 cm gjatësi. Ai u bë burri më i gjatë i botës pasi u zbulua se pakistanezi Muhamed Shana (i lindur më 1956) që pretendonte se arrinte 251 cm kishte mashtruar me 15 cm dhe nuk ishte veçse 236 cm i gjatë.

● Kazim Hysejn, iraken, 17 vjeçar, kapte gjatësinë 226 cm në shkurt të vitit 1985 por zgjatja e tij nuk ka mbuar. Ai ishte rritur me 7.6 cm vetëm gjatë 1984-ës.

Korresp. vullnetar

Kush ka mbetur prapa?

Të katër kandidatët për deputet për në Kuvendin Popullor që në Tepelenë fituan besimin e popullit i shihet të PPSH.

U gëzua shumica e popullit. Natyrisht pati dhe nga ata që nuk u gëzuan dhe thanë shumë. Thanë e ç'nuk thanë. Na bënë dhe të prapambetur e pa kulturë. Dhe pyetëm. I prapambetur populli i Tepelenës?! Po ai i Gjirokastrës, ai i Përmetit apo i Sarandës i prapambetur është pse nuk votoi për PD-në? Ka lloj lloj çudish. Është dhe kjo njera prej tyre. Sidoqoftë tepelenasi nuk ka një mendim të tillë për veten e tij.

Kujdesi për edukimin e fëmijëve është tregues i një populli të përparuar. Në Tepelenë 67 për qind e fëmijëve shkojnë në kopështe ndërkohë që në Tiranë shkojnë 62 për qind, në Shkodër 53 për qind dhe në Durrës 52 për qind. E po, do të thotë dikush, fëmijët e vegjël nuk kanë ku e kalojnë kohën. Marrim një tregues tjetër. Nga fëmijët që hynë në klasat e para në vitin shkollor 1982 - 1983 në vitin shkollor 1989 - 1990 arritën në klasën e 8 dhe e kaluan atë 89.3 për qind të tyre në Tepelenë, 80.3 për qind të tyre në Tiranë dhe 89% në Shkodër. Tepelena tërheq sot në shkollat e mesme 87 për qind të nxënësve që

mbarojnë klasat e 8-ta Tiranë 76 për qind, Shkodra 72 për qind dhe Durrësi 72 për qind. Mund ta quash të prapambetur një popull që tregon kujdes të veçantë t'i japë arsim të mesëm masë, dermuese të fëmijëve të tij? Edhe një shembull tjetër që nuk thotë pak. Kalushmëria e studentëve tepelenas të viteve të para në vitin e kaluar shkollor në UT dhe institutet e tjera të vendit ishte 88 për qind kur e atyre të Tiranës ka qenë 85 për qind, të Shkodrës 81 për qind, dhe të Durrësit 84 për qind.

Sigurisht që Tepelena e vogël prej 7 mijë banorësh apo rrethi me 50 mijë banorë, nuk ka teatër profesionist, nuk ka opera, nuk ka balet nuk ka institucione të tjera të kësaj kategorie por afro 1200 kuadro të lartë i ka nxjerr nga gjiri i tij. E nuk janë pak për një rreth si ky i yni 125 inxhinierë, 91 mjek, 200 specialistë të lartë bujqësie e mbi 360 arsimtarë me arsim të lartë. Të mos harrojmë vitin 1945 kur Tepelena kishte 80 për qind të popullsisë së saj analfabete.

Tepelena ka mbetur prapa për atë që nuk e njeh, Tepelena ka mbetur prapa për atë që e sheh me syzat e pasionit partiak.

Korresp. i «Lajmëtarit»

Hormova - histori e këngë

Me këtë shkrim do të doja që historinë e popullit të Hormovës ta kisha të gjithë brenda këtyre rreshtave. Dhëmbjet, këngët, gjakun, djersën, të gjitha t'i kisha. Dhe unë i thjeshti, punëtori që më shumë këngë sesa njerëz njoha në vite, të uletsha në prehrin e shekujve e historinë e tyre - piketë këngësh, ta lija për brezat që vinë.

Shumëkush që kalon Ujin e Ftohtë, në drejtim të Gjirokastrës, sa lë pas Muzhakën, në krahun e majtë të tij, shfaqet madhërisht, ulur në prehër të malit të Golikut, njeri nga fshatrat me historinë më të dhimbshme e më krenare, Hormova. Ashpërsia e Shkëmbit të Xhindeve, gjëmimi i Përroit të Thatë, ia lënë vendin të bukurit Gjonthoma dhe më poshtë Gurrës së Hormovës që duket sikur përjetësisht belbëzon fjalën jetë.

Qindra e mijëra breza. Muzeu flet. Dhe këngët. Në vargjet e tyre mbrujtur trimëria. Në gjirin e historisë shqiptare edhe Hormova. Bijtë e saj - fustanellë hapur, sfidojnë kohët. Gjak - këngë - gjak - jetë. Nderim për të rënë! Janë shumë. Shkrimi im nuk i kapërxen dot vitet '14. «Atë ditë si e

durove / Hormova me nure/. Dyqind e shtatëmbëdhjetë burra/ Vrarë në Hormovë». Fuqitë e mëdha shqyenin kufinj të Shqipërisë. Ka sot një lapidar në Hormovën martire. Pranë lapidarit një rrap. Rreth rrapit banorët e sotëm kanë ngritur një mur. Rrënjët e tij rriten, muri çahet. E çdo vit hormovitët murin. e ngrej-në më të ri, më të bukur, më të gjerë. Duket sikur ata, muri e lapidari janë një. Më beso lexues: Sa herë që shikoj rrapin nuk i gëzohem madhësisë por u gëzohem rrënjëve të tij të fuqishme. E tregojnë shumë historinë e Qafës së Xhemos këtu në Hormovë, ndërsa unë do ta them siç e kam dëgjuar. Histori - legjendë: - Xhemoja, ishte një trime. Fisi i burrit të saj është zhdukur sot në Hormovë, ndërsa të saj të janë Fatiajt. Lindi ajo katër djem. Ata dhe burri i saj u masakruan. Xhemoja jetoi. Më pas do t'ua linte vendin Hurmasë. Nevros e qindra grave të tjera hormovite që me dinjtet kombëtarë do të ngri-nin lart nderin e fshatit e tërë Shqipërisë.

Derë më derë të hormoviteve kam qenë. Sot habitem me disa pseudohistorianë që na thonë se «në 46

vite ç'keni bërë?». Dhe unë do t'u thosha të lexojnë historinë. Ta dinë që në Shkallën e Zezë, në shtator të '43 - shit, nën drejtimin e «Heroit të Popullit», Abaz Shehut u bë prita e parë kolonave naziste që vinin nga Greqia. Ta dinë se atë ditë u masakruan 32 burra të këtij trolli. Dhe është e vërtetë. Megjithatë i plagosur rëndë, babai i Bazos së Tote, shpëtoi për një moment dhe u fut në një derë. Hasmi e pa. Trimi kërkoi një dyfek. Hasmi, në mes të fëmijëve, lëshoi një breshërimë plumbash dhe... Trimi ra mbi vatër! Ra e la jetimë.

«Do të doja që nënë Nison ta kisha sot që lexuam t'i fliste. Ajo, nënë dëshmorë, që burri iu vra në masakrat e 1943-it, fjalëmbël e guzimmadhe e, ka mbetur në kujtesën time si shëmbëlltyrë e historisë. Nënati janë të dhëmbshura. Të bukurat të Dheut si në romanet kalorësiake mbase s'janë, por a ka gjë më tëmbël sesa qumështi që nga gjiri i tyre na dhanë! Jo! Kurrë.

E shoh Hormovën çdo ditë. E bukur, e rinuar. Sytë të e ardhmja. Tensionet e lektorale kanë pushuar. Të paktën kështu na e do zemra. Punë dhe vetëm punë. E ardhmja ndërtohet mbi themele djerse edhe këtu në Hormovë.

ZAHO BALILI